



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

KORRIK - SHTATOR 2021

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve boton numrin e tretë të revistës për vitin 2021, për periudhën korrik-shtator.

AIDA ka kthyer në traditë botimin e revistës periodike tremujore. Çdo vit, publikon 4 numra të newsletter-s me informacione të vlefshme për audiencën, grupet e interesit, bizneset dhe publikun më të gjerë. Në formatin e një 'buletini' elektronik, ndarë në disa rubrika, revista pasqyron evente, takime, webinare, sesione informuese/Info Day, Door to Door, AfterCare, trajnime, vizita, forume, panaire, bashkëpunime, botime e publikime, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, nisma apo fushata të rëndësishme që AIDA ndërmerr.

Secili nga numrat e revistës elektronike është njëherësh një 'dokumentim' që përmbledh aktivitetet përgjatë 3 muajve, një burimi informacioni që shfaq profilin e konsoliduar të AIDA-s dhe fushave që ka në fokus.



AIDA zhvillon veprimtarinë e saj për të fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos me përkrahjen e prodhuesve dhe produkteve vendase. Në funksion të një diplomacia ekonomike, jep kontribut në zgjerimin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike nëpërmjet dialogut me institucione që kanë në fokus investimet, rolit aktiv dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në evente që kanë si objektiv promovimin e Shqipërisë në fusha të ndryshme.


Mbështetja dhe asistimi profesional i investitorëve të huaj është një aspekt me prioritet të veçantë. Agjencia, veç tërheqjes së investimeve direkte në vendin tonë, ndërmerr nisja për rritjen e konkurrencës së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, (NVM) zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit, punon për promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke bashkëpunuar me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore.

Gjithashtu, në ndihmë të bizneseve vendase dhe produkteve 'Made in Albania', AIDA vijon fushatën promovuese 'E Dua Shqip'.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është proaktive dhe ka si përparësi mbështetjen e interesave ekonomike të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit si destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, si partner i besueshëm tregtar/i investimeve të huaja në sektorë potencialë si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia etj., si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të brendit shqiptar.

Për të rejtat më të fundit mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve vizitoni:

 @aida__albania  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  @investinalbania

 AIDA - Albanian Investment Development Agency



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al

tel: +355 042 251 001

web: www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në kuadër të masave të vazhdueshme të ndërmarra për mbrojtjen nga COVID-19, vijon të ofrojë shërbimet si më poshtë:

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e Investitorit Strategjik;
Dokumente të çfarëdollojshme, të cilat mund të përcillen nëpërmjet:

- Postës Shqiptare;
- E-mailit: info@aida.gov.al
- Pranë zyrave të AIDA-s, duke u lidhur më parë me stafin tonë dhe respektuar masat mbrojtëse kundër COVID-19.

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale të përditësuara.

SHQIPËRIA, PJESË E EXPO 2020 DUBAI

ÇELET EXPO 2020 DUBAI

U hap zyrtarisht më datë 01 Tetor 2021, panairi botëror Expo 2020 Dubai. Për gjashtë muaj rresht, Dubai mirëpret 190 vende të ekspozojnë arritjet e tyre në fusha të ndryshme dhe miliona vizitorë nga e gjithë bota.

Expo 2020 Dubai po zhvillohet nën moton “Connecting Minds, Creating the Future”, me besimin se inovacioni dhe progresi janë rezultate të njerëzve me prejardhje dhe fusha të ndryshme, të cilët mund të gjenerojnë dhe ndajnë ide unike duke kontribuar në zgjidhjen e sfidave globale.

Ekspozita organizohet rreth tre nëntemave: Mundësi (Opportunity), Lëvizshmëri (Mobility) dhe Qëndrueshmëri (Sustainability), duke shërbyer si platforma që nxisin kreativitetin, inovacionin dhe bashkëpunimin global.

Pavijoni i Shqipërisë është i vendosur në zonën e Lëvizshmërisë (Mobility), e cila ka në fokus krijimin dhe prezantimin e urave lidhëse fizike dhe virtuale produktive për lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe ideve, duke siguruar qasje më të lehtë në tregje, njohuri dhe inovacion.



AIDA, në rolin e institucionit koordinues, e përfaqësoar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Sokol Nano, në rolin e Komisarit të Përgjithshëm të Shqipërisë, do të menaxhojë dhe administrojë pavijonin shqiptar në panairin botëror Expo 2020 Dubai, përgjatë kohëzgjatjes 6-mujore.

Pavijoni i Shqipërisë në Expo 2020 Dubai nxjerr në pah vlerat tona në traditë, histori, kulturë, mikpritje dhe duke përçuar një shembull emancipimi, progresi, por edhe një përafrim të mirë ndaj sfidave të reja të kohës, teknologjisë dhe inovacionit.

Ceremonia zyrtare e hapjes së Pavijonit të Shqipërisë në Expo 2020 Dubai, u zhvillua më datë 2 Tetor.

Të pranishëm në ceremoninë e hapjes së Pavijonit të Shqipërisë ishin Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në rolin e Komisarit të Përgjithshëm të Shqipërisë, Ambasadori i Shqipërisë në Emiratet e Bashkuara Arabe, Z. Ermal Dredha, si edhe kuratori i pavijonit të Shqipërisë Z. Artan Shabani, i cili shpjegoi vendosjen e objekteve dhe tiparet artistike të pavijonit.



Ekspozita do të kulmojë me organizimin e Ditës Kombëtare të Shqipërisë, e cila do të mbahet më 9 Mars 2022 dhe i dedikohet aktiviteteve kulturore për të festuar identitetin kombëtar të vendit tonë.

Pjesëmarrja në panair, do të shërbejë si një mundësi e rëndësishme për promovimin potencialeve të Shqipërisë si një vend të favorshëm dhe të sigurt për të investuar. Gjithashtu, dhe për të promovuar Shqipërinë si një destinacion të veçantë dhe të qëndrueshëm turistik, duke shpalosur bukuritë e vendit tonë, kulturën dhe traditën e pasur shqiptare.

Albania a Timeless Trip!

AIDA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

AIDA shërben si një nyje lidhëse mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Qëllimi i saj është të ndërmarrë nisma të vazhdueshme që gjenerojnë rritje të qëndrueshme ekonomike, biznese të zhvilluara, mundësi për tërheqjen e investimeve të huaja në përputhje me profilin e burimeve dhe aspiratat e Shqipërisë.

AIDA është promotore e markës “Made in Albania”.

Në misionin e vet, vijon të mbështesë bizneset vendase duke zhvilluar sidomos sektorët prioritarë.

Gjatë vitit 2020 AIDA ka dhënë mbështetje konkrete ndaj biznesit vendas, ka ndikuar në thjeshtimin e procedurave për investitorët e huaj, vendosjen e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përçimin e informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimin e disa “out-reach campaign” në sektorët potencialë, realizimin e disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t’u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shënjon një strategji novatore, një vizion të ri në mënyrën e qasjes dhe zhvillimit të potencialit ekonomik të Shqipërisë.



FUSHATA #EDUASHQIP NË MBËSHTETJE TË BIZNESEVE SHQIPTARE DHE PRODUKTEVE ‘MADE IN ALBANIA’

AIDA, si një pikë qendrore për sipërmarrjen është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë, që gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësi dhe vlerat tona tradicionale. E Dua Shqip është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve/AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’.

Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera.

Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni përshkrimin dhe foto të produktit.

Rrënjët janë të rëndësishme.

Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.



Ada Herbs

Ada Herbs është një kompani e krijuar prej 8 vitesh, e cila merret me krijimin e produkteve organike për kujdesin ndaj flokut, lëkurës dhe trupit. Produktet unike të formuluar nga 'Ada Herbs' janë të testuara sipas standardeve europiane, me standardin e lëndës së parë organike COSMOS të certikuara. Disa nga produktet që 'Ada Herbs' ka sjellë në tregun shqiptar dhe jo vetëm janë kombinimi vajor për flokët, shampo, maska fytyre etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: contact@adaherbs.al ose në 069 585 7276.



Alpine Bees

Në Malësinë e Madhe, 'Alpine Bees' kujdeset të prodhojë mjaltin organik gourmet nga Alpet e së njëjtës zonë.

Mjalti gourmet, organik është sinonim i mjaltit të cilësise parësore, i cili i referohet llojit të mjaltit që prodhohet vetëm nga një lule ose nga një rajon specifik. 'Alpine Bees' sjell tre lloje produktesh që janë: mjaltë shumëlulesh, tuzme dhe gështenjë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@alpinebees.com ose në 067 524 8772.



Amortentia

'Amortentia' ose ndryshe 'Aromat e Mirqenies' është një linjë 'handmade' produktesh kozmetike dhe biologjike. E krijuar qënë vitin 2017, në Shkodër, ajo ka dalë në treg me një linjë produktesh me në bazë vajrat esenciale dhe ekstrakte vegjetale. Produktet përzgjidhen nga vendi ynë dhe janë teresisht natyrale. Produktet kryesore janë: sapuni natyral; vaji për buzë të thata; vaji i fytyrës; vaji i flokëve; vaji i trupit; etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: amortentia.albania@gmail.com ose në 067231 5400.



Birra 'Elbar'

'Elbar' është një birrë e prodhuar vetëm nga përbërës natyralë, shumë cilësorë nga kompania 'ALFA sh.p.k' në zonën e Dropullit.

Elbar është një emër i lashtë ilir, që mund të lexohet ndryshe si ELB – AR (elbi i artë). Ajo është një birrë e lehtë për t'u konsumuar dhe ideale për t'u përshtatur me shijet e gatimit dhe recetat tradicionale në Shqipëri.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: alfa.sa@agnagroup.com ose 04 245 3460



Birra KAON

Birra KAON ka bërë një rrugë të gjatë që nga hapja e saj në 1995. Që nga fillimi, qëllimi i kompanisë ka qënë të krijojë një birrë unike dhe popullore, duke ruajtur cilësinë, qëndrueshmërinë, etikën e biznesit dhe artin e prodhimit të birrës. Emri 'KAON' iu dha birrës prej fisit ilir Kaon, që jetoi në mijevjeçarin e parë para Krishtit në Shqipërinë e Jugut, të njohur për prodhimin e birrës.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kaonbeer.com ose në 067 208 3421.



Birra 'Korça'

Birra 'Korça' është një kompania e birrës, e themeluar në Korçë, në vitin 1928. Kompania është prodhuesi i tretë më i madh i birrës në Shqipëri. Fabrika vazhdon të prodhojë birrën tradicionale, duke ruajtur karakteristikat teknologjike të birrës 'Korça' ndër vite. Birra 'Korça' ofron për konsumatorin një cilësi të lartë, të ruajtur me fanatizëm ndër vite, duke mbajtur të njëjtat vlera dhe karakteristika. Shija e saj e veçantë eksportohet në Amerikë, Itali, Greqi dhe vendet e rajonit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@birrakorca.com.al ose në +355 68 609 4101.



"Jona's bio energy"

"Jona's bio energy" është krijuar si rezultat i një përkushtimi shumë të madh për natyrën. Ajo është një linjë 100% organike e një cilësie të lartë e prodhuar në Shqipëri. Formulat e produkteve janë të testuara nga dermatologët dhe linja është e certifikuar nga BIO ICDQ, certifikimi i cilësisë ICDQ shpk, ISO9001, ESYO. Linja "Jona's bio energy" është 'handmade', kuruese, antirrudhe dhe relaksuese me përbërje të levandës. "Jona's bio energy" ka produkte për çdo lloj problematike të lëkurës. E duam shqip dhe zgjedhim tonën ne.info@jonasbioenergy.com.al ose në 0696176181.



Kantina 'Bardha'

Kantina "Bardha" filloi aktivitetin e saj në 2006, duke prodhuar verë 100% shqiptare. E vendosur në një reliev të butë kodrinor, kantina "Bardha" ofron një peizazh të mrekullueshëm të rrethuar nga vreshta dhe ullishte. "Bardha" është e njohur për produktet e saj me cilësi të lartë duke prodhuar katër lloje varietesh autentike, si: Mavrud, Shesh, Merlot dhe Debinë. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kantinabardha@gmail.com ose në 069 403 0304



Kantina 'Duka'

I shtrirë në kodrat e Ishmit, vreshti "DUKA" gjendet midis pyllit dhe freskisë së erërave që e përqafojnë nga jugu. Prodhimi kryesor i kantinës "Duka" është vera e kuqe e prodhuar në tre varietet, Kabemet, Merlot, Tempranillo. Kujdesi për këto vera fillon që tek hardhia e toka, të cilat ushqehen vetëm me plehtrat organike, për të vijuar me mbrojtjen e hardsisë dhe mushit me produkte të regjistruara për bujqësinë bio. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kantinaduka.al ose në 068 601 3005



Kantina Hasanaj

Në fshatin Kocul, të bashkisë Selenicë, në një zonë kodrinore me një lartësi 350 – 400 metra mbi nivelin e detit, Kantina Hasanaj, kultivon vreshta të një cilësie të lartë. Duke përdorur rrushin autokton të kësaj zone, prodhohen vera Shesh i Bardhë, Duke përdorur metodat tradicionale në prodhim, Kantina Hasanaj kujdeset për të ruajtur të gjitha vlerat e produkteve që ofron. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: alberthasanaj2@gmail.com ose në 068 240 9429.



Kantina 'Herta'

Kantina "Herta" është e vendosur në Maminas të Durrësit dhe falë teknologjisë të instaluar italiane "Della Tofolla" ka mundësinë të prodhojë verëra të cilësisë së lartë dhe të jetë një konkurrense e denjë në tregun e verërave shqiptare. Me llojet e ndryshme të verës si Merlot, Trebiano, Toscano, Kabernet, etj., kantina "Herta" ka sjellë produkte mjaft interesante si Bukuroshja e Maminasit, Merlot Dyrrah, Kabëmet Savinjon, Merlot Trebiano etj. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kantinaherta.com ose në +355 (0)682046089.



Konserva Vloza

Konserva Vloza e themeluar në vitin 2011 është prezent në tregun shqiptar në të gjithë territorin gjeografik të vendit. Konserva Vloza realizon përpunimin dhe konservimin e peshkut sardele. Aktualisht ndërmarrja ka prodhuar dhe ka hedhur në treg tre produkte të peshkut sardele: sardele në vaj ulliri, sardele në vaj bimor, sardele me shije pikante. Produktet e Konserva Vloza janë certifikuar për sigurinë ushqimore me certifikatën HACCP. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@konservavloza.al ose në 067 200 5133.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Miell 'Atlas'

Miell 'Atlas' përfaqëson historinë e miellit me standartet më të larta të cilësisë dhe shijesve në furnat shqiptare që nga viti 1999. Kompania 'Atlas' operon sipas standartit të cilësisë ISO 9001:2000 dhe specifikimet e HACCP. Të gjitha pajisjet e mullirit dhe proceset e prodhimit inspektohen vazhdimisht dhe përditesohen në mënyrë që të ruhet cilësia e lartë e miellit 'Atlas' dhe të garantohet që përmbushen të gjitha kriteret e shëndetit, sigurisë dhe cilësisë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@atlas Mills.com ose në +355 (0) 67 20 66252.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Mjaltë – Bletari Bajrami

Që nga kohërat e lashta, mjalti është përdorur si ushqim dhe ilaç. Mjalti me cilësi të lartë përmban shumë antioksidantë të rëndësishëm, duke ofruar disa përfitime shëndetësore.

Në qytetin e Koplikut, Malësi e Madhe, prej 36 vitesh Besnik Bajrami kujdeset për mirëtin e bletëve, shtimin e tyre dhe prodhimin e mjaltit të pastër. Mjalti "Bajrami" njihet si produkt 100 % natyral dhe i certifikuar.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: arberbajrami1585@gmail.com ose në 069 767 4710



Pasta Diamond

Pasta Diamond është një produkt i prodhuar nga vetëm dy përbërës dhe të dy janë të cilësisë superior. Këto dy përbërës janë miell (semola) nga grurë i fortë dhe uji i trajtuar për prodhimin e makaronave.

Pasta Diamond është makarona me përqindjen më të lartë të proteinës, prodhuar në rajon dhe përmbush çdo standard Europian të cilësisë dhe prodhimit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@agoblend.com ose në 068 9043 666.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



'Rozafa' sh.p.k

'Rozafa' sh.p.k është emri shqiptar i industrisë së peshkut në tregjet e huaja që nga viti 1992. Ajo zoteron kompleksin më të madh të fabrikave të përpunimit të peshkut në Elbasan, duke ofruar shpërndarje në tregjet rajonale dhe europiane nëpërmjet prodhimeve tërësisht origjinale "Made in Albania". 'Rozafa' sh.p.k është kompania më e madhe e peshkimit në Shqipëri me një flotë prej 12 anijesh peshkimi dhe 4 qendra të rëndësishme përpunimi.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: elbasan@rozafa.al ose në 0697023017.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



"SERRA B" Sh.p.k

SERRA B "Sh.p.k, është themeluar në vitin 2008 dhe është e vetmja kompani në Shqipëri që prodhon kripë deti të jodizuara. Ajo përfshin disa procese si larja, jodizimi, përpunimi dhe paketimi i kripës. Fabrika e kripës ndodhet në Elbasan dhe prodhon i kripës realizohet nga një teknologji modern dhe e certifikuar. Kripa nga "SERRA B" sh.p.k është e jodizuar dhe me cilësi shumë të lartë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: manager@serrab.al ose në + 355 054243587.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Ujë "Glina"

Në fshatin Glinë, në juglindje të Shqipërisë, 25 km larg qytetit të Gjirokastrës, ka marrë emrin e burimit, uji 'Glina'. Ajo çka e bën ujin glina të veçantë është përmbajtja e tij e pasur me minerale të nevojshme për organizmin e njeriut. Uji 'Glina' është ujë bakteriologjikisht i pastër, konform ndaj standardeve ISO 9001/ ISO 22000 dhe përpunohet me një nga teknologjitë më të avancuara.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: alfasa@agnagroup.com ose në 0697723083.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Ujë 'Lajthiza'

Kompania "Lajthiza Invest" sh.a, është themeluar në vitin 1999 në Komunën e Qafës së Malit në fshatin Lajthizë, Pukë. Zona e rrethuar tërësisht me male mbizotërohet nga Mali i Roshit, nga i cili buron uji që derdhet në fshatin Lajthizë.

Uji "Lajthiza" është i kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme dhe është i certifikuar nga kontrolli i cilësisë HACCP. Shija e ujit "Lajthiza" ka një karakter unik të shijes.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@lajthiza.aen.al ose në +355 4 450 0420.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Ujë 'Tepelena'

Shoqëria "Uji i Pochtë Tepelenë" filloi aktivitetin prodhues në vitin 1998, në Tepelenë. Në laboratorin e kontrollit të cilësisë kryhen kontrolle të detajuara, që uji i ofruar konsumatorit të jetë në cilësinë dhe standardet më të mira. Uji "Tepelena" është i certifikuar me "Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë" sipas standardit ISO 9001:2015 nga Instituti Italian i Markës së Cilësisë si i vetmi përfaqësues në Itali i Rrjetit Ndërkombëtar të Certifikimeve IQNET.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@acquatepelena.com ose në 0676904262.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Ujë 'Vlora'

"Mustafaraj" sh.p.k është themeluar në vitin 1999 dhe njihet për ujin "Vlora". Kompania ka si aktivitet kryesor përpunimin, ambalazhimin dhe tregtimin e ujit të pijshëm.

Kjo kompani është e pajisur me mjete teknologjike moderne dhe merret me prodhimin e ujit në parametrat e duhur fiziko-kimik. Uji "Vlora" është konsoliduar në tregun shqiptar dhe është i certifikuar me patentë kombëtare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: mustafaraj.ujivlora@hotmail.com ose në 068 202 5951

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Vaj ulliri 'Gjirkondi'

Vaji ekstra i virgjër "Gjirkondi" prodhohet nga ullinjtë shekullorë "Kalinjot" të certifikuar organik, të cilët rriten në ullishte me sipërfaqe të vogla dhe të mesme që u përkasin fshatrëve. Fabrika ndodhet në fshatin Qeparo, përgjatë bregdetit Jon, një zonë me një traditë të hershme qindvjeçare në kultivimin e ullit.

Kjo fabrikë ofron një cikël teknologjik të mbyllur – nga grumbullimi, larja dhe përpunimi i ullinjve dhe ambalazhimi i vajit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: gjirkondinikolin@yahoo.com ose 069 228 2853

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Vaj ulliri 'Kallmet'

Kantina "Kallmet" kultivon varietetin e ullirit Kallmet dhe prodhon vajin me të njëjtin emër.

Zona e Kallmetit dhe fshatrat përreth, në një gjatësi gjeografike prej 30 km, kultivon 70% të ullinjve kallmet, i cili është varietet i lashtë autokton shqiptar.

Vaji "Kallmet" prodhohet me metoda moderne, por duke ruajtur elementet tradicionale.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kantinakallmeti.com ose në 068 203 5892

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Vaj ulliri 'Tre Miqtë'

Fabrika e vajit të ullirit "Tre Miqtë", në Ndroq, është krijuar në vitin 2006.

Në këtë fabrikë me standarde evropiane bëhet përpunimi i ullit duke prodhuar tre varietete të vajit të ullirit: extra i virgjër, i virgjër, dhe vaj ulliri. Produktet e kësaj fabrike janë prezantuar në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare duke u vlerësuar me certifikata cilësie.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: tremiqte@gmail.com ose në 068 207 3144



AKSES NË FINANCË PLATFORMA UNIKE PËR FINANCIMIN E BIZNESEVE

“Akses në Financë” është platforma më e re në vend që i dedikohet informimit të biznesit mbi burimet financiare. Dritarja unike, “Akses në Financë”, lindi si bashkërendim prioritetesh mes AIDA-s, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe mbështetjes së Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Platforma, si një instrument i rëndësishëm elektronik, u krijua për të qenë pika e parë e referimit dhe e qasjes nga Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme shqiptare, pasi ajo unifikon të gjithë informacionin mbi aksesin në financë, mundësitë financiare që tregu ofron, me grante, kredi dhe nisma të tjera financuese nga donatorë të sektorit privat dhe publik.

Sipërmarrës dhe individë me një ide biznesi, përmes këtij instrumenti të centralizuar, marrin në kohë reale të gjithë njoftimet mbi skemat financiare më të fundit, për çdo lloj SME-je dhe çdo sektor që ofrohet nga institucionet shtetërore, donatorë vendas dhe ndërkombëtarë.

“Akses në Financë” ofron shërbimin “one-stop-shop” me informacione që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në financë, ku skemat financiare që publikohen në platformë janë të aksesueshëm për të gjithë NVM-të, kompanitë Start-Up dhe individët me ide biznesi.

Për t'u njohur me platformën “Akses në Financë” vizitoni linkun: <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/te-reja-dhe-evente/te-rejat/1121-platforma-akses-ne-finance>




THIRRJE TË REJA



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mirëmban dhe përditëson me skema të reja financiare platformën “Akses në Financë”, duke ofruar informacionin më të fundit mbi mundësit e burimet financiare për NVM-të në Shqipëri. AIDA kujdeset që thirrjet e publikuar në platformë <https://aida-smefinance.gov.al/> të përmbajnë të dhënat thelbësore dhe të jenë shteruese në përcjelljen e informacionit për të orientuar një aplikim të suksesshëm dhe për të përmbushur në këtë mënyrë misionin që ka në mbështetje të biznesit vendas.

WEGATE THEMATIC GROUP – POLICIES AND PROGRAMMES FOR WOMEN ENTREPRENEURSHIP

AIDA njoftoi se është hapur thirrja për aplikime për ‘WEgate Thematic Group – Policies and Programmes for Women Entrepreneurship’, i cili synon të përmirësojë sipërmarrjen e grave duke lehtësuar krijimin e rrjeteve, ndarjen e praktikave të mira midis aktorëve, përmirësojë mbështetjen e dhënë në mënyrë efektive për gratë sipërmarrëse dhe për të motivuar më shumë gra për të filluar biznesin e tyre ose për të mbështetur zhvillimin e biznesit të tyre në të gjithë Europën. Vizitoni platformën Akses në Financë:



EBRD ADVICE FOR SMALL BUSINESSES IN ALBANIA

AIDA njoftoi të gjithë start-upet e interesuara në Shqipëri që kanë potencialin e rritjes dhe zgjerimit në tregun global të aplikojnë për programin “EBRD Star Venture” i cili ofron konsulta biznesi me konsulentë ndërkombëtarë, mentorim dhe mundësi për t’u lidhur me investitorë. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../erbd-advice-for-small...>



EU4BUSINESS: CONNECTING COMPANIES

AIDA njoftoi se hapet thirrja “EU4BUSINESS: CONNECTING COMPANIES”, objektivi i të cilës është të identifikojë, për secilin sektor ekonomik që kanë interes të përbashkët në përpunimin, menaxhimin dhe zbatimin e veprimeve nën mbikëqyrjen e Konsorciumit Sektorial përkatës. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../eu4business-connecting>.




ONTOCHAIN OPEN CALL 2

AIDA njoftoi se hapet thirrja: ONTOCHAIN 2, e cila ka si qëllim promovimin dhe mundësinë e rrjetëzimit që ofrohen si pjesë e këtij projekti. ONTOCHAIN fuqizon novatorët e internetit për të gjetur zgjidhje të besueshme të menaxhimit të njohurive të bazuara në blockchain, të cilat do të jenë pjesë e një ekosistemi të ri softueri. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/fina.../ontochain-open-call-2>




INTERCONNECTED INNOVATION ECOSYSTEMS (2021) (HORIZON-EIE-2021-CONNECT-01)

AIDA njoftoi se hapet thirrja: Interconnected Innovation Ecosystems (2021) (HORIZON-EIE-2021-CONNECT-01), fokusi i të cilës është në ndërtimin e ekosistemeve të ndërlidhura, inovative gjithëpërfshirëse në të gjithë Evropën duke u mbështetur në pikat e forta ekzistuese të ekosistemeve kombëtare, rajonale dhe lokale. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../interconnected...>



INNOVATION LAB (CREA-CROSS-2021-INNOVLAB)

AIDA njoftoi se është hapur thirrja: INNOVATION LAB (CREA-CROSS-2021-INNOVLAB). Objektivi i dy temave që do të mbulohen në mënyrë të veçantë është gjelbërimi në të gjithë sektorët krijues dhe kulturorë, si dhe mjetet inovative të edukimit duke përdorur kreativitetin dhe sektorët kreativë për të trajtuar temat përkatëse shoqërore siç është keqinformimi. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../innovation-lab-crea>



IDEA 2021


AIDA njoftoi se Qendra "Balance" si organizata zbatuese e projektit në konsorcium me RDA Tirana, kanë hapur thirrjen për aplikime në skemën IDEA për vitin 2021. Skema IDEA ofron grante për sipërmarrësit aspirantë si dhe sipërmarrësit ekzistues në Shqipëri. Vizitoni faqen: <https://idea.cfe.net/>.



GROWPRENEUR ACCELERATION PROGRAM

AIDA njoftoi se është hapur thirrja “GROWpreneur Acceleration Program”, nga YSB Balkans. “GROWpreneur” është një program i larmishëm dhe energjik, i dizenuar sipas metodave më bashkëkohore të ndërtimit të startup-eve, inspiruar nga eksperiencia Europiane dhe ajo e “Silicon Valley”. Ky është një program mbështetës dhe fleksibël për startupet që kanë tashmë një produkt në treg apo që janë në fazë rritje.


“GROWpreneur Accelerator Program” ofron trajnime nga ekspertë dhe mentorë internacionalë dhe lokal, si edhe mbështetje pas programit në një periudhë kohore prej 3 muaj.



FIT 4 START

AIDA, njoftoi se është hapur edicioni i 12-të i programit “Fit 4 Start”, i cili do të zgjasë nga muaji janar deri në qershor të vitit 2022. Fit 4 Start është programi kryesor për lançimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve start-up në Luksemburg dhe ju ofron sipërmarrësve trajnim intensiv, financim paraprak dhe përhapje të gjerë në rrjetet kryesore.

Ky program zhvillohet çdo vit që prej vitit 2015 nga Ministria e Ekonomisë së Luksemburgut, menaxhohet nga Luxinnovation dhe mbështetet nga Technoport dhe Inkubatori i Luksemburgut.



AIDA NË TAKIME DYPALËSHE



AIDA FORCON BASHKËPUNIMIN ME DHOMËN E TREGTISË SË BAGDADIT DHE DHOMËN E TREGTISË DHE INDUSTRIË ARABI - SHQIPËRI



Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, priti në takim Z. Alaa A. Zaier AlNoori, Anëtar i Dhomës së Tregtisë së Bagdadit njëkohësisht edhe Drejtor i Qendrës së Investimeve në Irak dhe Z. Yahia Farëati, përfaqësues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Arabi - Shqipëri. Takimi u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ekonomik Irak - Shqipëri.



Gjatë takimit u diskutua rreth fokusit të AIDA-s në ndihmë të investitorëve dhe mundësive për të realizuar takime të mëtejshme, duke shërbyer si një urë lidhëse mes sipërmarrjeve shqiptare dhe irakiane. Palët do të jenë në komunikim të mëtejshëm për vijimësinë e bashkëpunimit dhe konkretizimin e projekteve.

AKTIVITETE ONLINE




AIDA, PJESË E AKTIVITETIT ONLINE NË KUADËR TË DIASPORËS SHQIPTARE NË ITALI DHE INVESTIMEVE RECIPROKE ITALI – SHQIPËRI

AIDA mori pjesë në aktivitetin online me temë “Doing Business in Albania”, organizuar nga Konsullata Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në Milano. Fokusi kryesor i prezantimeve gjatë aktivitetit ishin arsyet pse duhet të investohet në Shqipëri.

Përfaqësues të AIDA-s prezantuan mundësitë e investimit në vendin tonë, incentivat specifike mbi sektorët prioritarë, gjithashtu një pasqyrim të shkëmbimeve tregtare Itali-Shqipëri dhe prezencës së kompanive italiane në tregun shqiptar.

Gjatë takimit u prezantuan gjithashtu edhe shërbimet që AIDA ofron, kryesisht procedurat e investimeve strategjike dhe asistencës së dhënë deri tani, ndaj bizneseve vendase dhe të huaja përmes sektorit After-Care.



INVESTIMET E HUAJA



KOMPANI TË HUAJA SYNOJNË PARTNERË BIZNESI NË SHQIPËRI

ALD-IMPORT LTD

Kompania bullgare "ALD-Import Ltd" ka shprehur interes për të vendosur kontakte dhe bashkëpunojë me kompani shqiptare në sektorin e produkteve mjekësore. Kompania është themeluar në vitin 2009 dhe merret me importimin dhe shitjen e produkteve si: doreza mjekësore dhe pajisjeve mbrojtëse.

AIDA ftoi kompanitë shqiptare dhe grupet e biznesit që operojnë në këtë fushë, dhe që e shohin me interes vendosjen e një partneriteti me "ALD-Import Ltd". të paraqesin kërkesat e tyre. Për më shumë informacion mbi kompaninë dhe produktet e saj, vizitoni faqen: www.aldimport.com




BASHKËPUNIM ME KOMPANINË IZRAELITE "ROOTS COMPANY"

Kompania izraelite "Roots Company" ka shprehur interes për të vendosur kontakte dhe bashkëpunojë me kompani shqiptare nga sektori i agrobujqësisë.

"Roots Company" e krijuar në vitin 2012, kombinon teknologjinë e qëndrueshme bujqësore me teknologjinë novator dhe revolucionare për të adresuar disa nga çështjet më kritike me të cilat përballlet bujqësia sot, si: adaptimin me ndryshimet e klimës dhe menaxhimin e burimeve ujore.

Teknologjia që kjo kompani aplikon siguron kosto të ulët të instalimit dhe zvogëlon konsumin e energjisë në mënyrë që fermerët të përfitojnë sa më shumë.

Për më shumë informacion mbi kompaninë vizitoni faqen: <https://rootssat.com/>.



FORUME



FORUMI EKONOMIK PËR BASHKËPUNIMIN RAJONAL

AIDA dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë (UCCIAL), në cilësinë e bashkorganizatorit, ishin pjesë e Forumit Ekonomik për Bashkëpunimin Rajonal që u zhvillua në Shkup, Maqedoninë e Veriut.

Në forum ishin pjesë Kryeministri i Shqipërisë Z. Edi Rama, Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Z. Zoran Zaev dhe Presidenti i Republikës së Serbisë, Z. Aleksandar Vuçiç.

Takimi u mbajt në kuadër të iniciativës së Bashkëpunimit Rajonal që njihet si "mini shengen" i Ballkanit dhe u finalizua me nënshkrimin e marrëveshjeve me qëllim lehtësimin e lëvizjes së njerëzve, thjeshtimin e formaliteteve të import-eksportit dhe lëvizjen e lirë të mallrave dhe forcimin e urave të bashkëpunimit mes 3 shteteve.

Forumit e ndoqi dhe Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano.

Forumit ekonomik bëri bashkë kompani nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia të cilat zhvilluan takime B2B me qëllim krijimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve.



FORUMI I SEKTORIT PRIVAT - BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

AIDA njoftoi se zhvillohet forumi i subjekteve të Sektorit Privat të Grupit të Bankës Islamike për Zhvillim (Grupit IsDB), datë 2 Shtator, Republika e Uzbekistanit.

Objektivi kryesor i forumit është të nxjerrë në pah nismat, aktivitetet, shërbimet e Grupit të Bankës Islamike për Zhvillim (IsDB), si edhe zgjidhjet e përbashkëta të grupit IsDB në vendet anëtare.

Forumit shërbeu si një platformë për krijimin e marrëdhënieve të biznesit dhe partneriteteve me përfaqësues dhe homologë nga komuniteti i biznesit, në mënyrë që të ndajnë përvojën e tyre, historitë e suksesit dhe praktikatat më të mira, si edhe të eksplorojnë së bashku mundësitë e investimit dhe tregtisë të ofruara nga Uzbekistani dhe vendet e CIS. Gjithashtu gjatë forumit u organizuan edhe takime B2B dhe B2G mes bizneseve të vendeve pjesëmarrëse.

SAMITI BOTËROR HALLALL DHE HALAL EXPO

AIDA informoi se në Qendrën e Kongresit të Stambollit (ICC), u mbajt edicioni i 8-të i panairit ‘Halal Expo’ dhe ‘Samiti i 7-të Botëror Hallall’.

Temat kryesore ishin mbi ushqimin dhe industrinë hallall, turizmin, kozmetikën, kujdesin personal dhe kërkimet shkencore në këtë sektor.

Pjesëmarrës ishin investitorë, kompani importi dhe eksporti, institucione publike, përfaqësues të misionit diplomatik, grupet e interesit, akademikë etj.



PANAIRE

AIDA FILLON PËRGATITJET PËR BIOFACH 2022

AIDA edhe këtë vit ftoi kompanitë të bëhen pjesë e panairit më të madh në botë në sektorin e produkteve organike dhe bimëve medicinale "BIOFACH 2022", i cili zhvillohet në datat 15-18 Shkurt 2022 në Nuremberg, Gjermani.

AIDA, me mbështetjen e partnerit SIPPO (Swiss Import Promotion Programme), filloi përgatitjet për organizimin stendës shqiptare, për të dytën herë në panairin e sektorit organik BIOFACH 2022.

Kompanitë pjesëmarrëse, do të kenë një hapësirë të veçantë në stendën shqiptare për të ekspozuar produktet e tyre, si edhe do të kenë mundësi të promovojnë markën në katalogun e panairit.





PËRDITËSIME DHE INFORMACIONE

TRANSFORMIMI DIXHITAL I NVM-VE – SEMINARI 3 "TREGTIA ELEKTRONIKE"

AIDA informoi se ekipi i BERZH për "Këshilla për Bizneset e Vogla" në partneritet me Shoqatën Shqiptare të TIK (AITA) dhe Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë zhvilluan workshopin e tretë online "Tregtia Elektronike", më 14 korrik 2021.

Çështjet që u diskutuan ishin: Tregtia elektronike; Elementet e tregtisë dhe roli i bankës; COVID-19, Impakti tek tregtia elektronike si dhe e nesërmja; Këshilla dhe rekomandime për NVM-të.

14 Korrik 2021 Ora 10:00 - 12:00
TRANSFORMIMI DIXHITAL I NVM-VE
 "TREGËTIA ELEKTRONIKE"
 Seminar III

 <p>Dritan Mezini Sipërmarrës/Konsulent i Transformimit Dixhital @dritanmezini</p>	 <p>Ardiola Hristic Menaxhere, Këshilla për Bizneset e Vogla, BERZH @ardiola-hristic-93b89b91</p>
 <p>Ersida Docaj Senior Banker EBRD @ersida-docaj-921a942</p>	 <p>Gjergji Guri Sipërmarrës/Drejtor Ekzekutiv i Facilizimit @gjergji-guri-1b05...</p>





INTERNATIONAL KINGDOM EXPO 2021 EKSPozITA DHE KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE JORDANEZE

AIDA informoi se u zhvillua online "International Kingdom Expo 2021", në datat 28 korrik - 2 gusht 2021.

IKE 2021 ishte ekspozita dhe konferenca e parë ndërkombëtare me fokus promovimin e produkteve dhe shërbimeve jordaneze.

Një platformë që synonte rrjetëzimin midis kompanive, organizatave, ofruesve të shërbimeve dhe tregut global, duke u mbështetur në dritare virtuale që e shndërrojnë botën në një 'fshat të vogël' për të shkëmbyer përvoja.

Konferenca ishte një mundësi për të diskutuar zhvillimet më të spikatura ekonomike dhe nivelin e gatishmërisë së sektorëve industrialë dhe tregtarë pas pandemisë

International Kingdom Expo
 Virtual Exhibition & Conference
28 July- 02 August 2021
www.kingdomexpo.jo





BRIDGE2EU

'Bridge2EU' është një program, i cili ndihmon kompanitë shqiptare, startup-et dhe 'scale-up' në fushën e teknologjisë, të eksplorojnë një ekosistem të ri.

Pjesëmarrësit patën mundësi të vizitonin ekosistemin e Bratislavës, investitorë, startup-e, si dhe të marrin njohuri për 5 ditë intensive me aktivitete informuese dhe rrjetëzuese.

Nëpërmjet programit 'Bridge2EU' kompanitë e përzgjedhura do të marrin ndihmë nga partnerë dhe do të asistohen në kuptimin e dinamikës së tregut dhe të lidhen me ekosistemin e rrjetit.



AIDA DHE EEN-ALBANIA SI BASHKËORGANIZATORË

INDUSTRY 4.0 INTERNATIONAL DAYS 2021

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve B2B që u zhvilluan on-line dhe fizikisht në eventin "Industry 4.0 International Days 2021", datë 7- 8 Shtator, Lyon, Francë.

Eventi ishte një mundësi për të takuar partnerë biznesi për projekte kërkimore teknologjike dhe industriale.

Target grupi i eventit përfshinte ekosistemin industrial duke filluar nga prodhuesit e pajisjeve teknologjike, nënkontraktimin industrial dhe deri tek qendrat kërkimore dhe inkubatorët.



DIGITAL RAIL CONVENTION 2021

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve B2B që u zhvilluan on-line dhe fizikisht në eventin "Digital Rail Convention 2021".

Takimet B2B që u zhvilluan në eventin Digital Rail Convention 2021, bënë bashkë kompani nga vende të ndryshme evropiane dhe ofruan mundësi për të krijuar kontakte dhe kontrata të reja biznesi.



DIGITAL ICT WEEK

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve që u zhvilluan online dhe fizikisht në eventin "Digital ICT Week".

Objektivi kryesor i aktivitetit ishte stimulimi i transformimit dixhital, ilustrimi i tendencave të fundit të teknologjisë dhe paraqitja e mundësive të rritjes për startup-et dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.



EXPO COOK 2021

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e takimeve që u zhvilluan në parrin virtual "Expo Cook 2021".

Takimet B2B kishin në fokus: Ushqimin dhe pijen, Produktet për sektorin HORECA, Pajisjet profesionale për bare, Restorante, Hotele etj.



MEET IN ITALY FOR LIFE SCIENCES

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset dhe të interesuarit të bëhen pjesë e takimeve online dhe fizike që u zhvilluan në eventin "Meet in Italy for Life Sciences".

Takimet B2B kishin në fokus: Shëndetësinë dhe farmacinë, Pajisjet Mjekësore, Bioteknologjinë, IT në sektorin e shëndetit etj.

Këto takime shërbyen si një mundësi për gjetjen e partnerëve të biznesit dhe krijimin e kontakteve dhe kontratave të bashkëpunimit brenda sektorëve të lidhur me energjinë.



WEGATE SUMMIT 2021

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan gratë sipërmarrëse të bëhen pjesë e aktivitetit online "WEGate Summit 2021".

Samiti WEGate 2021 mbështeste gratë sipërmarrëse, me ide transformuese, si dhe synonte të nxjerrte në pah politikat evropiane dhe strategjitë e financimit për një Evropë më të qëndrueshme, dixhitale dhe gjithëpërfshirëse.

Gjatë zhvillimit të samitit u shfaqen modelet e biznesit të



grave sipërmarrëse të suksesshme, ide dhe përvoja inovatore me qëllim rrjetëzimin dhe krijimin e bashkëpunimeve ndër-kombëtare në Evropë dhe më gjerë.

GREEN DAYS

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan të interesuarit të bëhen pjesë e aktivitetit “Green Days”.

Ky event u zhvillua online dhe fizikisht në Lyon Francë, dhe iu dedikohet sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, qendrave kërkimore dhe investitorëve që duan të zhvillohen në tregje të reja me fokus mjedisin, energjinë dhe ekonominë rrethore.



LEVANTE PROF

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e Forumit të Biznesit, të mbajtur në Fiera Del Levante, Bari.

Levante Prof është një ndër panairët më të mëdha që zhvillohet në Italinë e jugut me fokus sektorin HORECA, si edhe sektorët ushqim, bukë, pastičeri, akulllore, birrë, verë, konfeksione, makineri, teknologji dhe agrobiznes.

Gjatë panairit u zhvilluan forume biznesi dhe takime B2B me kompanitë pjesëmarrëse, për krijimin e kontakteve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit mes kompanive shqiptare dhe italiane.



ENERGY BUSINESS MEETINGS

AIDA dhe EEN-Albania, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ftuan bizneset të bëhen pjesë e aktivitetit online “Energy Business Meetings”.

Ky event përfshinte sektorët si: Energjinë, Energjinë e rinovueshme, Naftën, Gazin dhe fusha të ngjashme.

Takimet matchmaking dhe B2B, u zhvilluan në kuadër të Konferencës dhe Ekspozitës OMC 2021 - Med Energy, e njohur në mbarë botën si një ngjarje kryesore brenda sektorit të naftës dhe gazit, industrisë në det të hapur dhe shërbimeve të lidhura.

Takimet B2B shërbyen si një mundësi për gjetjen e partnerëve të biznesit dhe krijimin e kontakteve dhe kontratave të bashkëpunimit brenda sektorëve të lidhur me energjinë.



SME FEEDBACK

AIDA, në cilësinë e koordinatorit të projektit Enterprise Europe Network - Albania, ftoi bizneset të plotësonin pyetësonin 'SME Feedback'. Ky pyetësor i drejtohej sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare (NVM), të cilat janë të përfshira ose synojnë tregjet ndërkombëtare në Europë dhe me gjerë.

Pyetësori do të shërbejë si një matës i njohurive dhe shërbimeve që kanë apo synojnë të kenë NVM-të shqiptare mbi bërjen e biznesit në Evropë, njohjen e programeve mbështetëse evropiane, shërbimet e rrjetit Enterprise Europe Network, si edhe do të ndihmojë Komisionin Evropian të orientojë politikën mbështetëse të biznesit drejt nevojave të rëndësishme të tyre.



BOTIME

ZGJIDH TË VENDIT

Zgjidh të Vendit është katalogu vjetor i produkteve "Made in Albania". Në këtë katalog janë publikuar të gjitha produktet e ndërmarrjeve shqiptare për periudhën korrik 2020 - korrik 2021, të promovura në faqen web dhe rrjetet sociale të AIDA-s. Ky katalog prezanton 105 produkte, ku kryeson sektori i agropërpunimit dhe sektori i artizanatit.

EDuaShqip, nisi prej muajit korrik 2020, si një fushatë që promovon produktet "Made in Albania".

Klikoni linkun: <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1091-katalogu-vjetor-i-produkteve-made-in-albania>





SEKTORI I BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE (BMA)

Sektori i Bimëve Mjekësore dhe Aromatike (BMA) - Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të sektorit të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike ((BMA) në Shqipëri, statistika të viteve të fundit, proceset e punës, produktet dhe shërbimet kryesore, avantazhet e sektorit, histori suksesi, si edhe informacione mbi mbështetjen e sektorit nga shteti dhe AIDA.

Kliko linkun: <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1075-sektori-i-bimeve-mjekesore-aromatike>



EKONOMIA E USHQIMIT- BUJQËSIA

Ekonomia e Ushqimit- Bujqësia - Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të sektorit të bujqësisë në Shqipëri, avantazhet dhe mundësitë që ofron vendi ynë. Gjithashtu, në këtë broshurë do të njiheni me: mekanizmin, inovacionin dhe digjitalizimin në sektorin e bujqësisë, blegtorinë, peshkimin, agrobiznesin, agropërpunimin, bimët mjekësore dhe aromatike, bletarinë, agroturizmin, agropylltarin dhe mjedisin në zonat rurale.

Kliko linkun: <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1124-ekonomia-e-ushqimit-bujqesia>



FACTSHEET “SEKTORI I TURIZMIT”

Factsheet“Sektori i Turizmit”- Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje dhe prezantim të sektorit të turizmit në Shqipëri, arsyet përse duhet investuar në turizëm, proçedurat për investimet strategjike dhe zonat me prioritet zhvillimi.

Kliko linkun: https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Tourism_FactSheet.pdf



FACTSHEET “SEKTORI I AGROKULTURËS, AGROTURIZMIT DHE AKUAKULTURËS ”

Factsheet “Sektori i Agrokulturës, Agroturizmit dhe Akuakulturës” – Në këtë botim do të gjeni një përmbledhje të tre sektorëve, arsyet përse duhet të investoni në këta sektorë dhe proçedurat e investimeve strategjike.

Kliko linkun: https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Agriculture_FactSheet.pdf







AIDA


ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)  [AIDA - Albanian Investment Development Agency](https://www.facebook.com/AIDA-Albanian-Investment-Development-Agency)

 [AIDA - Albanian Investment Development Agency](https://www.linkedin.com/company/AIDA-Albanian-Investment-Development-Agency)